



Informacionet përkitazi kontrollit të Juaj shëndetsorë



Të gjithë parashtrueset dhe parashtruesit e kërkesave për mirënjohjen e të drejtës së azilit do të kontrollohen në mënyrë mjeksore, që në atë mënyrë eventualisht të mund vërehen sëmundje të mundshme infektive dhe në rast nevojë edhe të trajtohen në mënyrë mjeksore. Këto kontrole mjeksore sipas ligjit janë të obligueshme (§ 62 të Ligjit mbi Azilin) dhe njëherit pa nevojë pagese (falas). Në qoftë se këto kontrollime të bazuara në § 62 të Ligjit mbi Azilin refuzohen nga ana e parashtrueseve apo parashtruesve të kërkesave për mirënjohjen e të drejtës së azilit, ëshë e mundshme që Organi përkatës i strehimit të zbatojë ato kontrole në rast nevojë edhe me anë të masave të dhunshme

Ne kuadër të kontrollit do të regjistrohen në lidhje me Ju shenime të veçanta shëndetësie (rezultatet nga kontrolli i mushkrive-, gjakut- dhe në raste nevojë edhe të stolit (jashtëqitjes)). Këto shenime nevojiten, që të mund vërehet një sëmundje infektive shumë shpejtë dhe në rast nevojë të mund trajtohet ajo sëmundje në mënyrë mjeksore, që të mund mbrohen njerëz tjerë nga një infektim me sëmundjen e njejtë.

Rezultati i atij kontrolli mjeksor do të ju jipet në informatë Organit përkatës, të cilët janë kompetentë për vendosjen e Juaj nën strehim. Në qoftë se zbulohet tek Ju një sëmundje infektive, atëherë Ju do të informoheni në lidhje me të njejtën dhe njëherit në rast nevojë edhe do të trajtoheni në mënyrë mjeksore. Përveq kësaj njëherit gjithashtu do të informohet edhe Enti i Shëndetsisë i cili është kompetent për vendbanimin e Juaj (§ 62 të Ligjit mbi Azilin dhe §§ 25, 28 të Ligjit mbi mbrojtjen ndaj sëmundjeve infektive).

Ju gjithashtu kini mundësin të shifni rezultatet e juaja dhe të kërkonit të ju jipet juve një kopje e tyre.

Kontrolli i mushkërive (X-Rrezet (Rentgeni))

(prej përfundimit të moshës 15. vjeçare në lidhje me një sëmundje infektive të mushkërive)

- ▶ Tuberkuloza është një sëmundje infektive e ndezjes së mushkërive, e cila në qoftë se nuk trajtohet në mënyrë mjeksore shkatërron mushkëritë dhe njëherit mund të marrë një rrjedhim vdekjeprurës. Sëmundja e tillë shpeshëhere fillon pa patur fare ankime, më vonë vjen deri tek kollitja, humbje e peshës ose djersitje. Një Tuberkulozë e mushkërive mund të vërehet nëpërmjet një fotografie me X-rrezet (Rentgeni) e më pastaj mund të shërohet me përdorimin e medikamenteve. Një Tuberkulozë e cila ka mbetur pa u vërejtur fare mund të sulmojë gjithashtu edhe organe tjera të brendshme trupit dhe njëherit të dëmtoj ato për gjithmonë. Mu për këtë arsye është shumë e rëndësishme të behet një zbulim në fazë fillestare nëpërmjet të kontrollit me X-Rrezet.
- ▶ Tek fëmijët ose tek gratë shtatëznë në vend të një kontrolli me X-Rreze të mushkërisë behet një kontrollim i gjakut (IGRA-Testi).

Kontrolli gjakut

(në lidhje me sëmundjet infektive të gjakut dhe të mëlçisë)

- ▶ Hepatitis B: Është një sëmundje infektive virale, e cila mund të transferohet nëpërmjet të gjakut apo nëpërmjet kontaktit seksual. Kjo sëmundje shkakton një inflamacion të mëlçisë.
- ▶ HIV I dhe II: Është një sëmundje infektive virale, e cila mund të transferohet nëpërmjet të gjakut apo nëpërmjet kontaktit seksual. Kjo sëmundje shkakton sëmundjen e SIDA-së (AIDS (acquired immunodeficiency syndrome)) dhe pa një trajtman mjeksor rrjedhon gjithnjë në mënyrë vdekjeprurëse.



Kontrolli i stolit (jashtëqitjes)

(sipas mundësie në lidhje me sëmundjet infektive në zorrë), për shembull përgjat jashtëqitjeve të barkut ose me shenja sëmundjeje tek personat me të cilët ju keni patur kontakt.

- ▶ Grupi i patogjenëve-Tifusi-Paratifusi-Enteritis: Kontrolli i bakterieve, të cilat mund të krijojnë një jashtëqitje barku.
- ▶ Parazitët e zorrës (si për shembull skrrajat).

Vaksinimi

Vaksinimet janë masat preventive më efikase që ekzistojnë në mjeksi.

Ato ju mbrojnë juve ndaj sëmundjeve infektive.

- ▶ Për të mund mbrojtur vetveten apo familjen Tuaj ndaj sëmundjeve infektive – siq për shembull kundra sëmundjes së Fruthit- ju lutemi të ju drejtohuni shërbimit mjeksor të institucionit ku jeni të vendosur apo të ju drejtohuni një prakse mjeksore. Vaksinimi ju ofrohet juve pa pagesë fare (falas).

Informacionet përkitazi kontrollit të Juaj shëndetsorë



Kontrolli i mushkërive (X-Rrezet)

Fotografimi i mushkërisë me X-Rrezet (Rentgen)

Pas mbushjes së moshës 15.vjeçare

(tek fëmijët apo gratë shtatëzënë kontrolli i gjakut)



Kontrolli i gjakut

Pas mbushjes së moshës 15. vjeçare: Hepatitis B, HIV I und II

Tek fëmijët dhe gratë shtatëzënë: Testi i Tuberkulozës.



Kontrolli i stolit (jashtëqitjes)

Në raste nevojë në lidhje me infektet e zorrës dhe në rast se kemi të bëjmë edhe me parazitët e zorrës, siq për shembull në rast jashtëqitjeje barku



Vaksinimi

Ofertë vaksinimi falas për të gjitha parashtueset dhe parashtuesit e kërkesave për mirënjohjen e të drejtës së azilit

AUTORËSIA

Botuesi: Bayerisches Staatsministerium für Gesundheit und Pflege
Haidenauplatz 1, 81667 München
www.stmgp.bayern.de

Gjendja: Nëntor 2015
Numri i artikullit:stmgp_asyl_005

Përpilimi: CMS – Cross Media Solutions GmbH, Würzburg
Vërtetimi me fotografi:
fotolia.com: Alexandra G; annakharchenko
Printimi: Druckerei Schmerbeck GmbH, Tiefenbach